VENDIM
Nr. 59, datë 10.3.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "GEGA-G" SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 189/12 prot., datë 7.3.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

Në lidhje me procedurën e ndjekur të rinovimit të licencës rezulton se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 23, datë 20.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 8.4.2020.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 21.1.2025 dhe 22.1.2025). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 30.1.2025), nuk rezultoi të ketë komente apo objeksione nga të tretët.

1. Vlerësimi paraprak mbi plotësimin e dokumentacionit

- Me shkresën nr. 189/2 prot., datë 22.1.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar që të japë sqarime, në lidhje me dokumentacionin që ka pësuar ndryshime nga ai i depozituar në aplikimin për licencim.

- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 189/3 prot., datë 4.2.2025, nga ku ka rezultuar se nuk është dhënë ky informacion, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 10.2.2025, u vendos zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë e vendimmarrjes së Bordit, me qëllim që shoqëria të sjellë shpjegimet për ndryshimet, apo modifikimet e mundshme të dokumentacionit të aplikimit.

2. Vendimmarrje e ndërmjetme dhe organizimi i seancës dëgjimore

- Me vendimin nr. 38, datë 10.2.2025, ERE vendosi zgjatjen e vendimmarrjes me 30 ditë, periudhë gjatë së cilës shoqëria duhet të dorëzojë shpjegimet mbi ndryshimet apo modifikimet në dokumentacion.

- Me shkresën nr. 189/6 prot., datë 17.2.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore, seancë e cila është zhvilluar në ERE në datën 24.2.2025, ku shoqërisë iu sqarua i gjithë informacioni/dokumentacioni i munguar që nevojitet të depozitohet prej saj në këtë aplikim, e konkretisht dhënia e informacionit mbi çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues nga shoqëria

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 189/7 prot., datë 3.3.2025 dhe *email*-in nr. 189/12 prot., datë 7.3.2025, ka depozituar informacion plotësues për aplikimin. Në kuadër të dokumentimit të mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, shoqëria ka depozituar dokumentacion (vërtetime të gjendjeve të llogarive të saj bankare), që garanton ushtrimin e kësaj veprimtarie për një muaj, por duke qenë se ajo ushtron dhe veprimtari të tjera, nuk ka deklaruar shumën e cila do të vendoset në dispozicion për këtë veprimtari nga totali i të ardhurave të saj që ka dokumentuar në ERE.

4. Vendim i ndërmjetëm për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes

- Në nenin 67, të ligjit nr. 44/2015, "Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: gjatë një procedure administrative, autoriteti publik mund të nxjerrë vendime të ndërmjetme që nuk përfundojnë çështjen, por që janë të nevojshme për vazhdimin e saj.

- Me qëllim zhvillimin e korrespondencës me shoqërinë dhe depozitimin nga ana e saj të deklaratës përkatëse për fondet që vë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, vlerësohet e arsyeshme shtyrja deri në 20 (njëzet) ditë e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë deri në 20 (njëzet) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "GEGA-G" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti